



Adresimi i Dhunës Seksuale Online Ndërmjet Të Rinjve

Rekomandimet e Të Rinjve për Parandalim dhe Reagim

Përmbledhje: Rritja e numrit dhe përdorimi i shtuar i mediave sociale kanë ndikuar në krijimin dhe përhapjen e disa fenomeneve, duke përfshirë dhunën seksuale ndërmjet të rinjve në internet. Kjo dhunë manifestohet në mënyra të ndryshme si shpërndarja e pamjeve intime pa pëlqim dhe miratim, ngacmimi seksual përmes mediave sociale dhe kërcënimet për favore seksuale.

Hulumtimi i kryer me 93 të rinj të moshës 13-19 vjeç nga Shqipëria, Kanadaja dhe Kenia tregoi se 47% e të rinjve të anketuar kanë përjetuar diçka që ata do ta quajnë dhunë seksuale në internet dhe vetëm gjysma prej tyre e kanë raportuar këtë formë dhune. Për më tepër, të rinjtë u shprehën se dhuna seksuale mes të rinjve online është pranuar dhe shihet si sjellje normale te të rinjtë. Një e katërta e të rinjve raportuan se kanë përjetuar personalisht dhunë seksuale në internet nga një bashkëmoshatar, ndërsa 59% deklaruan se një mik i tyre kishte përjetuar ngacmime seksuale nga i ri tjetër. Përvoja më e zakonshme ishte marrja e fotove ose videove seksuale ose nudo, ndjekur nga publikimi i komenteve të papërshtatshme në internet.

"Mendoj se abuzimi në internet shpesh çon në abuzim seksual jashtë internetit. Shpesh fëmijët fillojnë të zihen në internet dhe më pas vazhdojnë të zihen fizikisht në shkollë. Gjithashtu, vajzat mund të kontaktohen online, të tërhiqen dhe manipulohen dhe më pas të abuzohen seksualisht." - i ri nga Tirana.

Ky dokument politik përshkruan ndikimin e dhunës seksuale mes të rinjve në internet dhe propozon strategji dhe rekomandime për t'a parandaluar apo adresuar atë. Ndërhyrjet efektive, të propozuara nga vetë të rinjtë, kërkojnë përpjekje të koordinuara mes tyre, familjes, edukatorëve, politikëbërësve dhe kompanive të teknologjisë.

Gjetje

Ndikimi i Dhunës Seksuale Online mes të Rinjve:

Pasojat e dhunës online seksuale mes të rinjve janë të rënda dhe të shumëfishta, duke ndikuar në mirëqenien mendore, emocionale dhe fizike të të rinjve. Ndër të tjera, të rinjtë renditën:

Përkufizime nga Të Rinitë:

Fyerje: - Kjo është një situatë ku dikush të abuzon verbalisht duke përdorur seksionin e komenteve online për të folur keq për ty.

Pornografi hakmarrëse: - Kryhet kryesisht nga partnerët që janë ndarë nga një lidhje dhe ndihen të hidhëruar apo pikëlluar. Ky mund të jetë një akt ku dikush përdor internetin ose Inteligjencën Artificiale (IA) për të redaktuar një video pornografike për ta bërë të duket sikur je ti në të.

Shantazh seksual: - Ndodh kur dikush përdor një foto nudo tënden ose me ndihmën e IA krijon një foto nudo tënden dhe më pas fillon të të kërcënojë të bësh diçka, veçanërisht të japësh para, përndryshe ata e ekspozojnë atë publikisht.



- **Trauma psikologjike:** Stresi, ankthi dhe depresioni.
- **Izolimi social:** Largimi nga shokët dhe aktivitetet e shkollës ose komunitetit.
- **Dëmtimi i vetes:** Rritja e incidenteve të lëndimit të vetes dhe mendimeve vetëvrasëse.

Të rinjtë raportuan se ekspozimi në internet ndaj përmbajtjeve të dëmshme dhe abuzimi online lë shumë pasojë psikologjike të cilat bëhen edhe më të rënda kur dhuna ndodh dhe jashtë internetit.

Të rinjtë raportuan se fëmijët e moshës 13 deri në 18 vjeç janë në rrezik më të madh për dhunë seksuale online pasi ata eksperimentojnë më shumë dhe janë përdorues më të shpeshtë të internetit. Ata gjithashtu shprehën shqetësime për sigurinë e tyre gjatë përdorimit të aplikacioneve të ndryshme si Tik Tok, Snapchat, pasi janë më të ekspozuar ndaj dhunës seksuale.

Sipas tyre, të rinjtë janë më të prirur të përjetojnë bullizëm online dhe dhunë psikologjike, me vajzat që janë më të ekspozuara ndaj dhunës seksuale online dhe përtej internetit.

"Unë mendoj se njerëzit përjetojnë shqetësime të thella kur hasin komente negative në postimet e tyre, veçanërisht ato që lidhen me pamjen fizike – aspekte që individët nuk mund t'i ndryshojnë lehtë. Është thelbësore që ne të ofrojmë mbështetje të fortë për shokët që ndihen keq për shkak të këtyre komenteve, duke njohur që ata mund të jenë duke u përballur me depresion dhe janë në rrezik të dëmtojnë veten." – e re nga Shupenza.

Sfidat Aktuale

- **Mungesa e Ndërgjegjësimit dhe Edukimit:** Nuk ka mjaftueshëm njohuri midis të rinjve, prindërve, mësuesve dhe punonjësve psiko-socialë për atë që përbën dhunën online seksuale mes të rinjve dhe pasojat e saj. Gjithashtu, mungojnë informacionet mbi masat e sigurisë në internet dhe parandalimin e abuzimit.
- **Kuadri i Pamjaftueshëm Ligjor:** Ligjet ekzistuese nuk janë mjaft të forta për të adresuar nuancat e dhunës seksuale në internet të të miturit. Kodi penal në Shqipëri ka mangësi në klasifikimin e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve në internet si një krim.¹
- **Pengesa Teknologjike:** Sipas përvojave të të rinjve, platformat e mediave sociale dhe aplikacionet e mesazheve shpesh nuk kanë mekanizma të përshtatshëm raportimi dhe masa efektive të kontrollit të përmbajtjes, duke i bërë ato vende të pasigurta për navigim.
- **Shërbime të pamjaftueshme dhe mungesa e informacionit:** Sa i përket burimeve dhe shërbimeve të disponueshme për individët që kanë përjetuar dhunë seksuale, mbeten problem mungesa e fondeve të mjaftueshme, mungesa e shërbimeve në zona të ndryshme, sidomos rurale, mungesa e kujdesit të specializuar për popullata të ndryshme (p.sh., fëmijë, emigrantë), dhe pengesat në aksesimin e shërbimeve për shkak të stigmatizimit ose diskriminimit. Të rinjtë pjesëmarrës në studim deklaruan se nuk kanë

¹ ECPAT International (2020). ECPAT (ECPAT Country Overview: Albania)



informacion mbi shërbime konkrete mbështetëse që ofrohen për të rinjtë, viktime të abuzimit online, edhe pse ekzistojnë linja të ndihmës, shërbime këshillimi dhe strehimore në vend.

- Mungesa e hulumtimeve të thelluara dhe të ndryshme mbi dhunën seksuale online mes të rinjve: Vazhdojnë të ekzistojnë boshllëqe të mëdha përsa i përket hulumtimeve gjithëpërfshirëse dhe të larmishme mbi këtë temë. Gjetjet nga shqyrtimi i dokumenteve tregojnë se studimet ekzistuese janë të kufizuara, shpesh të përqendruara në grupe të caktuara demografike ose rajone gjeografike, dhe nuk arrijnë të identifikojnë dhe raportojnë mbi gamën e plotë të përvojave dhe ndikimeve. Për më tepër, ka nevojë për metodologji dhe qasje të ndryshme kërkimore për të kuptuar më mirë shpërndarjen, shkaktarët dhe pasojat e kësaj lloji dhune.

Vizioni për një Hapësirë të Sigurtë Online nga të Rinjtë Shqiptarë:

Një vend pa viruse, reklama të rreme dhe mashtrime. Pa fëmijë të varur dhe duke humbur kohën duke ndarë informacion privat ose duke abuzuar hapësirën private të të tjerëve në internet. Një vend pa gjuhë urrejtjeje, ngacmim, foto dhe video të papërshtatshme që shfaqin dhunë dhe materiale seksuale.

Metodologjia: Për realizimin e studimit u përdor një metodologji mikse, duke filluar me një shqyrtim të detajuar të literaturës ekzistuese. Një Këshill Rinor, i përbërë nga gjashtë të rinj nga Shqipëria, Kanadaja dhe Kenia, udhëhoqi konceptimin dhe zbatimin e studimit. Workshope me pjesëmarrje të të rinjve u organizuan në dhjetor 2023 në Shqipëri dhe në Kenia, duke përfshirë 35 të rinj të moshës 13-18 vjeç. Në këto workshope të rinjtë u angazhuan në mbledhjen dhe analizën e të dhënave. Një anketë u shpërnda te 87 të rinj online në tri vendet (41% ishin të rinj të moshës 13-15, 49% ishin mes 16-18 vjeç dhe 11% ishin 19 vjeç e sipër; 22% ishin djem dhe 76% vajza), duke u fokusuar në përvojat e tyre online. Për më tepër, secili shtet i përfshirë në studim eksploroj rreziqet lokale dhe burimet, platformat, shërbimet, institucionet, OJQ-të dhe palët e interesuara kyçe të angazhuara në mbrojtjen dhe mbështetjen e fëmijëve.

Të rinjtë shqiptarë që morën pjesë në kërkim:

- ✓ 2 këshilltarë të rinj
- ✓ 25 të rinj bashkë-kërkues
- ✓ 35 të rinj të përfshirë në anketën online

Rekomandime: Për të parandaluar dhe adresuar dhunën seksuale mes të rinjve në internet, të rinjtë rekomanduan veprimet e mëposhtme:

Investim në fushata ndërgjegjësimi dhe programe edukuese gjithëpërfshirëse.

- Të zhvillohen fushata ndërgjegjësimi që synojnë informimin e të rinjve, prindërve dhe profesionistëve në shkollë mbi sigurinë online dhe çështje si dhuna seksuale online.

Të edukohen prindërit dhe familjet mbi rreziqet që fëmijët përballen në internet, llojet e dhunës, shenjat e para të dhunës, pasojat, si dhe ku të referohen dhe raportohen rastet e abuzimit.

- Të integrohen kurrikulat mbi sigurinë në internet dhe edukimi mbi përdorimin e përgjegjshëm të teknologjisë në kurrikulën shkollore, duke u fokusuar në njohjen, parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale në internet.
- Të promovohet edukimi mbi marrëdhëniet e shëndetshme dhe edukimin seksual për fëmijët dhe të rinjtë. Të përfshihet edukimi seksual në kurrikulat shkollore, në cdo nivel arsimor.
- Të hartohen programe të zhvillimit pozitiv për të rinjtë, për të rritur vetëvlerësimin, ndjenjën e përkatësisë dhe empatinë, si dhe për të inkurajuar krijimin e marrëdhënieve të shëndetshme me bashkëmoshatarët e tyre.

Forcimi i shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve:

- Të përditësohen dhe forcohen ligjet për median sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve për të adresuar specifikisht dhunën seksuale online, duke siguruar që abuzuesit të marrin dënimin e duhur dhe viktimave tju jepet mbrojtja dhe shërbimet e nevojshme.
- Të bashkëpunohet me ekspertët për të krijuar udhëzime të qarta për shkollat dhe komunitetet mbi trajtimin e incidenteve të dhunës seksuale online.
- Të ofrohen shërbime të specializuara, këshillim dhe mbështetje për viktimat dhe autorët e dhunës seksuale online.
- Të krijohen dhe promovohen më tej linja të dedikuara për ndihmë dhe burime online për viktimat, duke ofruar këshillim konfidencial dhe konsulencë ligjore falas.

Forcimi i sigurisë online përmes partneriteteve strategjike me kompanitë teknologjike:

- Të bashkëpunohet me kompanitë e teknologjisë për të përmirësuar efikasitetin e sistemeve të raportimit në platformat e mediave sociale dhe të komunikimit online.
- Të zbatohen rregullat e privatësisë dhe të njoftohen përdoruesit nëse një material online është i papërshtatshëm për fëmijët. Po ashtu, të identifikohen dhe fshihen menjëherë përmbajtjet me gjuhë urrejtjeje dhe të dëmshme për audiencën.

Angazhimi i komunitetit dhe i prindërve:

- Të inkurajohen dhe edukohen prindërit që të përfshihen në dialog të hapur me fëmijët e tyre për sjelljen në internet dhe çështje që lidhen me dhunën seksuale.
- Të organizohen workshope/ punëtori në komunitet për të pajisur prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve me aftësitë e nevojshme për të monitoruar aktivitetet online të fëmijëve dhe për t'i udhëzuar në formën e duhur.
- Të angazhohet komuniteti në programe ndërgjegjësimi për parandalimin e dhunës dhe për raportimin e rasteve të abuzimit.

Projekti: Përvojat e të Rinjve lidhur me Dhunën Seksuale Online mes Të Rinjve, Normat Shoqërore dhe Rekomandimet e Drejtuar nga Të Rinjtë për Parandalim dhe Reagim: Një Studim Ndër rajonal (*Shkurt 2023-Janar 2025*)

Financuar nga: End Violence dhe Tech Coalition

Zbatuar nga: Royal Roads University (RRU), Terre des Hommes (TdH) në Shqipëri, Kenya Alliance for the Advancement of Children (KAACR) dhe International Institute of Child Rights and Development (IICRD).

*Për informacione të mëtejshme, kontaktoni: **Ilva VJERO** (Menaxhere për Cilësinë dhe Llogaridhënien, Terre des hommes) ilva.vjero@tdh.org*